




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 30.03.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 243, të datës 03.03.2020, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 46, paragrafi 46.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare 27/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit 2019

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 11,645,281.00€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 5,397,795.20€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,320,871.40€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,893,339.18€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 33,275.22€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





58
30.03.2020
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 30.03.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2020, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentit financiar Nr. 312, të datës 23.03.2020 dhe Propozimit të Shtabit Emergjent të Komunës për menxhimin e epidemisë së Coronavirus-in COVID - 19, shqyrtimin të propozimit edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15.03.2020, nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 404,000.00€ për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe të tjera në luftën me pandeminë e Coronavirus-it COVID - 19

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 404,000.00€, për vazhdimin e masave parandaluese dhe masave tjera shtesë të nevojshme nga Shtabi Emergjent i Komunës së Fushë-Kosovës për parandalimin e përhapjes së sëmundjes ngjyës Coronavirus-it COVID - 19.
2. Shuma e mjeteve financiare prej 154,000.00€ janë mjete financiare të destinuara për shpenzim para alokimit të buxhetit të komunës për vitin 2020, ndërsa shuma tjetër e mjeteve financiare prej 250,000.00€ janë mjete financiare që do të shpenzohen nga buxheti i komunës i vitit 2020, pas alokimit të buxhetit në funksion të luftës kundër pandemisë së Coronavirusit.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të alokuara për shpenzim në proces dhe vijues sipas procedurave të dokumentit financiar Nr. 312, të datës 23.03.2020 dhe zërave buxhetor, shih për këtë analitikën që është pjesë e këtij vendimi është si vijon:
 - 3.1 Për pastrimin - dezinfektimin fshirjen dhe larjen e rrugëve dhe hapësirave publike në nivelin e komunës, shuma e mjeteve financiare prej 45,000.00€;
 - 3.2 Për dezinfektimin e objekteve kolektive banesore hyrjeve-daljeve, objektet afariste, shuma e mjeteve financiare prej 32,000.00€;
 - 3.3 Furnizimin dhe pajisjen me material mjekësorë në funksion të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve, shuma e mjeteve financiare prej 50,000.00€;
 - 3.4 Furnizimin me ushqim të thatë për personelin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi', Qendrës për Punë Sociale dhe të tjera të domosdoshme

- në funksion të kohëzgjatjes së krizës emergjente, shuma e mjeteve financiare është 12,000.00€;
- 3.5 Furnizimin me pako ushqimore dhe mjete hixhenike për nevojat e qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, shuma e mjeteve financiare është 10,000.00€;
- 3.6 Furnizimin me miell për nevojat e qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, shuma e mjeteve financiare është 5,000.00€;
- 3.7 Vazhdimin e furnizimit me bukë për 700 familje të komuniteteve pakicë dhe familjeve tjera varësisht prej nevojave të qytetarëve, është nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
4. Shpërndarja e shumës së mjeteve financiare prej 250,000.00€, bëhet pas alokimit të buxhetit për vitin 2020, sipas nevojave të paraqitura në kohë të caktuar për nënparagrafet e cekura 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafët e cekur në vijim:
- 4.1 Gjetjen e mundësisë së përshtatshme për përkrahjen e mundshme dhe stimulimin e punëtorëve shëndetësorë me mjete financiare të punësuarë në Projektin e Karitasit, mjekëve, informerëve dhe stafit mbështetës;
- 4.2 Çështje tjera eventuale që Shtabi Emergjent i Komunës vlerëson se janë në funksion të parandalimit të përhapjes së sëmundjes ngjitëse COVID - 19, me një përshkrim plotësues të detajizuar dhe arsyetuar.
5. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një, dy dhe shpërndarja sipas pikës tre dhe katër të vendimit bëhet nga buxheti i komunës para alokimit dhe pas alokimit të buxhetit për vitin 2020, nga kodet ekonomike të programeve prej mallërave e shërbimeve dhe kodet ekonomike të projekteve kapitale prej të gjitha Drejtorive të Komunës, Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe Zyrës së Kuvendit të Komunës, përmes Drejtorisë së Financave e Buxhetit, duke marrë parasysh edhe Udhëzimet e Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Transfereve për lëvizjen e 5%, të mjeteve financiare nga projektet kapitale të vitit 2020.
6. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorive tjera të Komunës.
7. Për mjetet financiare të shpenzuara për parandalimin e sëmundjes ngjitëse informohet Kuvendi i Komunës.
8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes nga Kuvendi i Komunës në funksion të parandalimit të përhapjes së sëmundjes ngjitëse Coronavirusit COVID -19, njoftimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

